



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government



Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrasnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs
Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademia za Javnu
Bezbednost/Kosovo Academy for Public Safety
Fakulteti i Sigurisë Publike/Fakulteta Javne Bezbednosti/Faculty of Public Safety

Nr. 16/2026
Dt. 28.05.2026

Bazuar në nenin 14 paragrafi 1 të Rregullores (AKSP) Nr. 01/2019 për Punën e Sistemit të Menaxhimit Universitar në AKSP, si dhe në nenin 16 paragrafi 6 të Rregullores (AKSP) Nr. 01/2020 për Studimet Themelore Bachelor, u.d. Dekani, me datë 28.05.2026, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Afati për paraqitjen në SMU të provimit “Tema e diplomës” për studentët e Fakultetit të Sigurisë Publike fillon nga data 20 deri më 25 të çdo muaji kalendarik.
2. Pavarësisht pikës 1 të këtij vendimi, për muajin maj 2026, afati për paraqitjen në SMU të provimit “Tema e diplomës” hapet nga data 28.05.2026 deri më 31.05.2026.
3. Të drejtë për paraqitjen e provimit “Tema e diplomës” kanë studentët të cilët kanë përfunduar fazën e mentorimit dhe kanë lejim nga Komisioni për vlerësimin e temës së diplomës.
4. Obligohen Shërbimi Studentor që në koordinim me DTI, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi, përfshirë hapjen teknike të afatit në SMU, verifikimin e listës së studentëve që i kanë përmbushur kushtet dhe njoftimin e studentëve përkatës.
5. Njoftimi për këtë vendim publikohet në SMU dhe në ueb-faqen zyrtare të AKSP-së, ndërsa studentët njoftohen edhe përmes e-mail-it në koordinim me mentorët e kandidatëve.
6. Të drejtë për mbrojtjen e temës së diplomës kanë vetëm studentët që e kanë paraqitur provimin “Tema e diplomës” përmes SMU-së.
7. Për kushtet, kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e temës së diplomës zbatohen dispozitat e Rregullores (AKSP) Nr. 01/2020 për Studimet Themelore Bachelor dhe vendimi nr. 14/155, dt. 25.05.2026 i Këshillit të FSP-së.
8. Ky vendim zbatohet për vitin kalendarik 2026 dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vushtrri, më: 28.05.2026

Kopja iu dërgohet:

- Shërbimeve Studentore të FSP-së;
- Stafit akademik të FSP-së;
- Divizionit të Teknologjisë Informativë (DTI);
- Arkivët të AKSP/FSP.

Prof. Asoc. Dr. Vilard Bytyqi
u.d. Dekan

